



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 14, paragrafi 2, dhe Dispozitat e Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 17 paragrafi 3 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
- Kërkesën e KOSTT për aprovimin e dokumentit "Procedura për monitorimin e përbushjes së standardeve të kualitetit dhe furnizimit me energji elektrike";

në seancën e mbajtur me datë 21 nëntor 2014, nxori këtë:

**V E N D I M**

**I Aprovohen dokumenti "Procedura për monitorimin e përbushjes së standardeve të kualitetit dhe furnizimit me energji elektrike"**

**Arsyetim**

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE) me datë 15.07.2013 ka pranuar kërkesën KOSTT Sh.a. për aprovim të dokumentit "Procedura për monitorimin e përbushjes së standardeve të kualitetit dhe furnizimit me energji elektrike".
- o Dokumenti është përgatitur bazuar në dokumentin e ZRRE-së: Standardet e Kualitetit të Energjisë Elektrike – Tabelat me përmbledhjen e standardeve të propozuara, që përfshinë standardet për Operatorin e Sistemit të Transmisionit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesin Publik.
- o ZRRE ka analizuar dokumentin dhe ka dhënë komentet e veta në dokument.
- o Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, KOSTT ka dërguar versionin final të dokumentit me datë 20.11.2014. Pas kësaj, ZRRE ka vlerësuar se dokumenti i dërguar "Procedura për monitorimin e përbushjes së standardeve të kualitetit dhe furnizimit me energji elektrike" i përmbush kriteret për aprovim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.**



III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

*Vendimit i bashkëngjitet dokumenti "Procedura për monitorimin e përmbushjes së standardeve të kualitetit dhe furnizimit me energji elektrike"*

**Bordi i ZRRE-së**

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar